



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Udhëzues për Përcjelljen e Rekomandimeve të Auditimit të Performancës

Prishtinë, dhjetor 2021

Përmbajtja

1.	HYRJE.....	4
2.	AKTIVITETI PËRCJELLËS I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS	5
2.1	Synimi dhe qëllimi i përcjelljes në auditim të performancës.....	5
2.2	Përcjellja e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit.....	6
3.	PËRCJELLJA E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE.....	8
3.1	Procedurat përcjellëse	8
3.2	Planifikimi përcjellës	9
3.3	Monitorimi i progresit të zbatimit të rekomandimeve	9
3.4	Auditimet pasuese.....	10
3.5	Raportimi i rezultateve të përcjelljes	11
4.	PËRSHKRIMI I SISTEMIT PËRCJELLËS TË REKOMANDIMIT TË AUDITIMIT 12	
4.1	Databaza për rekomandimet përcjellëse të auditimit	12
	Shtojca 1, Tabela 1: Databaza e Rekomandimeve Përcjellëse të Auditimit.....	17
	Shtojca 2, Tabela 2: Raportet e auditimit me rekomandime të zbatuara dhe progresi i zbatimit deri më 20xx	18
	Shtojca 3. Diagrami i rrjedhës së procesit përcjellës të auditimit së ZKA.....	1

Shkurtesat

SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit
ISA	Institucioni Suprem i Auditimit

1. HYRJJE

Procesi i auditimit nuk përfundon me nxjerrjen e raportit të auditimit apo me përgatitjen e planit të veprimit për adresim të rekomandimeve nga subjekti i audituar, pasi që këto veprime nuk ofrojnë siguri që këto rekomandime do të zbatohen. Për këtë qëllim, është e nevojshme të bëhet monitorimi i zbatimit të rekomandimeve në baza të rregullta. Monitorimi është një *proces përcjellës* gjatë të cilit auditorët vlerësojnë përshtatshmërinë, efektivitetin dhe afatet kohore të veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti i organizatës së audituar për të adresuar çdo rekomandim të auditimit. Procesi përcjellës do të lehtësojë zbatimin efektiv të gjetjeve dhe rekomandimeve të auditimit. Gjithashtu do t'i ofrojë informatë kthyese ISA-it, legjislativit dhe qeverisë lidhur me efektivitetin e auditimit të performancës dhe përmirësimet e bëra nga subjekti i audituar (SNISA 3200). Auditori, sipas nevojës, do të bëjë përcjelljen e gjetjeve dhe rekomandimeve të mëparshme të auditimit dhe ISA do t'i raportojë legjislativit, nëse është e mundur, për konkluzionet dhe ndikimet e të gjitha veprimeve përkatëse korrigjuese (SNISA 3000/136). Raporti përcjellës i raportit të auditimit është një mjet i rëndësishëm për të fuqizuar ndikimin e auditimit dhe për të përmirësuar punën e auditimit në të ardhmen, prandaj është një pjesë e vlefshme e procesit të auditimit (SNISA 3200).

Pas nxjerrjes së raportit të auditimit të performancës, prej të audituarit kërkohet që të sigurojë një plan të shkruar veprimi ku specifikohet koha dhe mënyrat e zbatimit të rekomandimeve të dhëna. Siç përcaktohet edhe në raportet e auditimit, zbatimi i rekomandimeve në kohë është një nga qëllimet e ZKA. Lidhur me këtë, ZKA duhet të krijojë një sistem që ruan të gjeturat dhe/ose rekomandimet e mëparshme të auditimit si dhe aktivitetet e ndërlidhura të cilat i ka pranuar i audituari. Monitorimi i aktiviteteve siguron informata kthyese ISA-së, Qeverisë dhe Parlamentit lidhur me rezultatet e auditimeve të kryera. Auditori duhet ta përqendrojë përcjelljen në atë, nëse subjekti i audituar i ka adresuar problemet në mënyrë adekuate dhe ka përmirësuar gjendjen themelore pas një periudhe të arsyeshme (ISSAI 3000/139).

Pas një periudhe kohore, ISA mund të kryejë një vlerësim shtesë për përparimet e arritura të subjektit të audituar lidhur me gjetjet e auditimit dhe rekomandimet e dhëna për zbatim dhe raportin mbi shqyrtimin për masat korrigjuese. Kjo do të thotë që, bazuar në planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve pas publikimit të raportit, duhet të kontrollohen pikat në vijim:

- Cilat janë reagimet dhe cilat janë komentet e hisedarëve të ndryshëm?
- Çfarë tjetër mund të mësojmë nga auditimi dhe procesi në tërësi - si mund të bëjmë përmirësime?
- A ka shenja që auditimet e kryera kanë mungesë të cilësisë, dhe nëse po, cilat mund të jenë arsyet dhe shpjegimet?
- Çfarë është bërë deri tani në lidhje me auditimin dhe rekomandimet e dhëna, cilat janë rezultatet?
- A ka argumente në lidhje me auditimin dhe rekomandimet e tij, duke pasur parasysh se ndërmarra e veprimeve është më se e nevojshme?

2. AKTIVITETI PËRCJELLËS I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

Përcjellja e rekomandimeve të auditimit të performancës rrit efektivitetin e aktiviteteve të institucionit suprem të auditimit, përfshirë ndikimin e auditimit, si dhe rritjen e llogaridhënies ndaj publikut. Është me rëndësi që të mbahet komunikim i mirë me menaxhmentin e subjektit të audituar apo me subjekte që kanë lidhje me aktivitetet e audituara. Komunikimi i mirë siguron efektivitetin e procesit të auditimit.

Ekipi i auditimit duhet t'ia shpjegojë menaxhmentit rëndësinë e secilit rekomandim si dhe pasojat të cilat do t'i bartë subjekti nëse nuk i përmbush ato. Ndikimi i auditimit mund të identifikohet nëpërmjet efektit të veprimit korrigjues të ndërmarr nga palët përgjegjëse, apo nëpërmjet ndikimit të gjetjeve dhe konkluzioneve të auditimit lidhur me qeverisjen, llogaridhënien, të kuptuarit e problemit të adresuar apo qasjen ndaj tij.

2.1 Synimi dhe qëllimi i përcjelljes në auditim të performancës

Gjatë kryerjes së raporteve përcjellëse të auditimit, synimi është që të përcaktohet nëse veprimet e ndërmarr lidhur me gjetjet dhe rekomandimet kanë përmirësuar gjendjen themelore. Kjo do të thotë që, reagimet pozitive si dhe ato negative lidhur me auditimin dhe raportin e auditimit duhet të shqyrtohen nga auditori. Prandaj, është e rëndësishme të zbatohet një qasje e paanshme. Pas publikimit të raportit të auditimit të performancës, aktivitetet përcjellëse kontribuojnë në zbatimin efektiv të rekomandimeve nga ana e institucioneve të audituara.

Përcjellja e gjetjeve dhe rekomandimeve të auditimit mund të shërbejë për katër qëllime kryesore:

- a) Të identifikohet në çfarë mase subjektet e audituara kanë zbatuar ndryshimet në përgjigje të gjetjeve dhe rekomandimeve të auditimit;
- b) Përcaktimin e ndikimeve që mund t'i atribuohen auditimeve;
- c) Identifikimi i fushave të dobishme për përcjellje në të ardhmen; dhe
- d) Vlerësimin e performancës së ISA-ve. Përcjellja ofron bazë për vlerësimin e performancës së ISA dhe mund të kontribuojë në njohuri më të mira dhe praktika të përmirësuara në ISA. Kështu që, raporti përcjellës i raporteve të auditimit është gjithashtu një vegël e vetëvlerësimit.

Përcjellja e zbatimit të rekomandimeve në ZKA duhet të sigurojë:

- Rritje të efektivitetit të raporteve të auditimit, arsyeja primare e raportit përcjellës të auditimit të performancës është, që të rriten gjasat që rekomandimet do të zbatohen;
- Ndhimesë organeve ekzekutive dhe legislative, raportet përcjellëse mund të kenë rëndësi duke ndikuar që të ndërmerren veprime nga organet legislative;

- Ofrimin e bazës për vlerësim të performancës së rekomandimeve të dhëna si dhe vetë ISA; dhe
- Të shërbejë si stimul për aktivitetet e të mësuarit dhe zhvillimit, procesi i përcjelljes së performancës mund të kontribuojnë në rritje të njohurive dhe përmirësim të praktikave të auditimit.

Ekipi i auditimit të performancës dhe menaxhmenti i ZKA merr pjesë gjatë procesit përcjellës, ashtu që veprimet pas publikimit të raportit mund të ndahen në aktivitetet e ekipit të auditimit dhe aktivitetet e menaxhmentit të ZKA¹.

Në vijim janë të pasqyruara aktivitetet e ekipit të auditimit:

- Krahasojnë planin e punës me punën aktuale të kryer;
- Rekomandime për aktivitete përcjellëse; dhe
- Implementojnë auditime pasuese.

Në vijim janë të pasqyruara aktivitetet e menaxhmentit të ISA:

- Vendimmarrje lidhur me politikën e aktiviteve mbështetëse;
- Përcaktimin e datës për fillimin e aktiviteve mbështetëse; dhe
- Metoda e raportimit të rezultateve të aktiviteve të mbështetura.

Është më se e ditur që është shumë vështirë të izolohet ndikimi i raportit të auditimit në kontekst të ndryshimeve të tjera të rëndësishme, kështu që përqendrimi i auditorit duhet të jetë më tepër nëse ka bërë korrigjimin e dobësive, sesa në atë nëse rekomandimet specifike janë zbatuar apo jo. Faktori kyç mbetet pyetja nëse rekomandimet e auditimit janë zbatuar dhe ky faktor shpesh mund të provojë të jetë i vetmi tregues i matshëm i ndikimit.

2.2 Përcjellja e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit

Rekomandimet në raportin e auditimit të performancës duhet të monitorohen për të përcaktuar përparimin e zbatimit të tyre, cilat masa janë ndërmarr nga institucioni kompetent për t'i zbatuar këto rekomandime dhe të identifikohen shkaqet nëse rekomandimet nuk janë zbatuar. Koha dhe shtrirja e aktivitetit përcjellës varen nga vendimet e menaxhmentit të ZKA. Letër e veçantë duhet t'i dorëzohet subjektit të audituar në varësi të llojit përcjellës.

Aktivitetet mbështetëse për rekomandime mund të bëhen në disa mënyra të ndryshme. Më të zakonshmet janë: kontaktet e drejtpërdrejta me subjektin e audituar apo përmes kërkesave zyrtare për sigurim të informatave, si dhe auditime pasuese. Mënyra më e thjeshtë është që të mbahen takime me klientin pas një kohe të caktuar për të përcaktuar se

¹ Shtojca 3 Diagrami i rrjedhës së procesit përcjellës të auditimit të ZKA

çfarë hapash ka ndërmarrë klienti për të përmirësuar efikasitetin e tij dhe të kontrollohet nëse rekomandimet janë zbatuar dhe të ofrohet dëshmi të zbatimit aty ku është e mundur.

Pas nxjerrjes së raportit të auditimit të performancës, shqyrtimit dhe miratimit të raporteve nga ana e Parlamentit, nga i audituari mund të kërkohet t'i përgjigjet legjislativit apo ZKA lidhur me çështjet që ndërlidhen me zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit të performancës.

3. PËRCJELLJA E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE

Vendimi për të kryer aktivitetet përcjellëse për të ndikuar në rekomandime duhet të bazohet në një analizë të rezultateve të informatës kthyeje që mbështesin aktivitetet për rekomandime. Nëse ka indikacione që institucionet kompetente janë të ngadalshme në zbatim të rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit të performancës, ose janë ndërmarrë veprime të dobëta në drejtim të koordinimit të veprimeve të tyre, apo edhe kanë vështirësi për të kuptuarit që të gjitha veprimet janë të nevojshme, ka arsye të mira për aktivite mbështetëse për të ndikuar në rekomandime si dhe auditim pasues.

Aktivitetet e ISA kërkojnë shumë përpjekje dhe analiza për matje të efekteve të rekomandimeve. Aktualisht, një auditim i ri i performancës, është ai i cili duhet të mbulojë se si zbatohen rekomandimet si dhe shumë çështje të tjera që mund të ndikojnë në rezultate. Vlerësimi i ndikimit në çdo rast është thelbi i këtij aktiviteti dhe ofron bazë për efektivitetin e rekomandimeve të auditimit të dhëna në raportin e auditimit të performancës.

Procedurat për përcjellje të rekomandimeve të auditimit përfshijnë:

- Konfirmim i afatit kohor brenda të cilit janë të nevojshme përgjigjet e menaxhmentit lidhur me të gjeturat dhe rekomandimet e auditimit;
- Vlerësimi i përgjigjeve të menaxhmentit; dhe
- Auditimi përcjellës (nëse është i nevojshëm).

3.1 Procedurat përcjellëse

Mund të përdoren mënyra të ndryshme për të kryer përcjellje ndaj të gjeturave dhe rekomandimeve. Në vijim janë të paraqitura disa shembuj:

- a) Caktoni një takim me palët përgjegjëse pas një kohe të caktuar për të gjetur çfarë veprime janë ndërmarrë për të përmirësuar performancën dhe për të kontrolluar cilat rekomandime janë zbatuar.
- b) Kërkoni nga palët përgjegjëse që të informojnë ZKA me shkrim lidhur me veprimet që kanë ndërmarrë për të adresuar problemet e paraqitura në raportin e auditimit.
- c) Bëni thirrje telefonike apo vizita të kufizuara në terren për të mbledhur informacion lidhur me veprimet e ndërmarra nga subjekti i audituar.
- d) Informohuni në vazhdimësi lidhur me reagimet nga palët përgjegjëse, legjislativi dhe mediat, dhe analizoni nëse problemet e identifikuara janë adresuar në mënyrë të duhur apo jo.
- e) Kërkoni nga auditimi financiar që të mbledh informacion rreth veprimeve të ndërmarra si pjesë e procedurave të tyre të auditimit.

f) Kryeni auditim përcjellës, i cili do të rezultojë në raport të ri të auditimit të performancës.

Mënyrat që do të përdoren do të varen nga prioritetet e vendosura nga ZKA gjatë procesit të planifikimit strategjik dhe vjetor për auditim të performancës. Ato gjithashtu ndikohen nga rëndësia e problemeve të identifikuara, veprimet që pritet të zbatohen dhe interesi i jashtëm për informacion lidhur me veprimet e ndërmarra.

3.2 Planifikimi përcjellës

Për planifikim të duhur të aktiviteteve përcjellëse të implementimit të rekomandimeve, auditorët duhet të plotësojnë bazën e të dhënave, e cila përmbledh rekomandimet nga auditimet e mëparshme. Afati kohor për monitorimin e përmbushjes së rekomandimeve është i cekur në këtë data bazë, kështu që aktivitetet e zbatimit monitorohen në kohë për zbatim të secilit rekomandim.

Planifikimi i përcjelljes dhe si të aplikohet ky proces varet prej faktorëve vijues:

- Rëndësia e procesit të audituar dhe dobësitë e zbuluara;
- Kostot dhe përpjekjet që lidhen me përmirësimin e procesit të audituar;
- Rreziku i ndodhjes së ndonjë ngjarjeje eventuale, përveç nëse ndërmerren masa korrigjuese;
- Fushëveprimi i veprimit korrigjues për të siguruar që të gjitha subjektet relevante aplikojnë përmirësimet e nevojshme; dhe
- Afati kohor për zbatim të ndryshimeve.

3.3 Monitorimi i progresit të zbatimit të rekomandimeve

Përcjellja mund të bëhet përmes monitorimit apo përmes auditimit përcjellës.

Monitorimi do të ishte i përshtatshëm atëherë kur:

- Procesi i audituar apo aktiviteti nuk ka rëndësi të madhe dhe nuk paraqet pengesë serioze për arritjen e objektivave kryesore të organizatës;
- Dobësitë, gabimet, mangësitë ose parregullsitë e identifikuara nuk janë më të rëndësishmet;
- Rekomandimet e dhëna janë lehtësisht të zbatueshme; apo
- Veprimi korrigjues nuk është i komplikuar.

Auditori mund të monitorojë progresin përmes:

- Pranimi dhe vlerësimi të përgjigjeve të menaxhmentit ndaj gjetjeve të auditimit brenda një periudhe të arsyeshme pas njoftimit të rezultateve të auditimit;
- Pranimin të herëpashershëm të të dhënave të reja nga menaxhmenti i organizatave të audituara, me qëllim të vlerësimi të gjendjes së punës për të korrigjuar dobësitë e raportuara;
- Raportim mbi statusin e përgjigjeve ndaj gjetjeve të auditimit.

3.4 Auditimet pasuese

Gjatë kryerjes së raportit përcjellës të auditimit, auditori duhet të përqendrohet në gjetjet dhe rekomandimet që janë ende relevante në kohën e raportit përcjellës. Veprimi i pamjaftueshëm apo i pakënaqshëm nga subjekti i audituar mund të kërkojë një auditim të pasues nga ZKA. Auditimi pasues është i ngjashëm me auditimin tradicional të performancës, megjithëse objektivat dhe fushëveprimi janë të kufizuara për t'u përqendruar në mangësitë e vërejtura në raportin e mëparshëm. Në shumë raste, puna e auditimit do të jetë e mjaftueshme për të bërë përcjelljen e rekomandimeve pa kryer auditime pasuese. Megjithatë, nëse ka vendim nga ana e menaxhmentit për të zbatuar auditime pasuese, është e nevojshme të dihet që planifikimi i auditimit pasues është po aq i rëndësishëm sa planifikimi dhe studimet e tjera dhe kërkon formën e njëjtë si plani i punës dhe studimi kryesor. Auditimet pasuese duhet të përfshihen në planin e auditimit strategjik, dhe vendoset nga menaxhmenti i ZKA në varësi të prioritetit të dhënë.

Auditimi pasues aplikohet në cilëndo nga rrethanat vijuese:

- Kur në auditim paraprak janë identifikuar gabime serioze dhe mangësi/parregullsi;
- Kur ekziston një rrezik i lartë kur menaxhmenti nuk ndërmerr veprimet korrigjuese;
- Ku zbatimi i rekomandimeve kërkon përgatitjen e mëtejme të rregullave dhe rregulloreve të brendshme;
- Kur ndryshimi i kërkuar i referohet aktiviteteve të një apo më shumë subjekteve;
- Kur nevojiten burime të shumta për të futur ndryshime tek subjekti.

Ashtu si edhe auditimi i rregullt, auditimi përcjellës përmban të njëjtat procedura të planifikimit, performancës dhe raportimit, duke shtuar disa procedura të posaçme si në vijim:

- Shqyrtimin e gjetjeve të auditimit nga raporti i mëparshëm, për të përcaktuar fushëveprimin e auditimit përcjellës;
- Hartimin e testeve dhe procedurave adekuate të auditimit për vlerësim të veprimeve korrigjuese;
- Kryerjen e punës së auditimit në terren dhe dokumentim të rezultateve të punës së kryer të auditimit;

- Verifikimin dhe shqyrtimin e datave të caktuara për zbatim nëse kërkohet; dhe
- Nxjerrjen e raportit përcjellës të auditimit.

Gjatë auditimit përcjellës, duhet të nxirren konkluzione nëse veprimet e menaxhmentit kanë ndikuar në reduktimin e rreziqeve të identifikuar në auditimin e mëparshëm dhe nëse ato kanë përmirësuar funksionimin e organizatës drejt arritjes së qëllimeve të saj.

Fushëveprimi i auditimeve pasuese duhet të përshkruhet në planin e punës dhe të përcaktohet në bazë të vlerësimit të:

- Rëndësisë së konkluzioneve fillestare;
- Masave korrigjuese të ndërmarra nga institucionet kompetente;
- Veprimit dhe ndikimit të tjerëve që nuk janë objekt i auditimit; dhe
- Rëndësisë së faktorëve të jashtëm dhe çështjeve tjera.

Raportimi lidhur me auditimet pasuese kryhet në përputhje me parimet e përgjithshme të raportimit. Raportim për auditim pasues mund të mos kërkohet, dhe për nevojën e aktiviteteve të tilla, vendoset nga menaxhmenti i ISA. Vendimi varet nga vlerësimi i ZKA për gjetjet dhe konkluzionet e auditimit përcjellës.

Devijimet dhe përmirësimet e identifikuar në auditimin pasues duhet të qëndrojnë dhe gjithmonë të raportohen tek subjekti i auditimit. Veprimet pozitive në zbatimin e rekomandimeve të auditimit duhet çdoherë të theksohen, sepse ato janë meritë e ZKA.

Ekzekutimi i auditimit përcjellës të performancës është i rëndësishëm për vlerësimin e përfitimeve dhe përparimit që ka ndodhur si rezultat i auditimit të performancës. Ndihmon për të vlerësuar më mirë efektivitetin e auditimit të performancës në drejtim të përmirësimit të shërbimeve dhe efekteve të përgjithshme të sektorit publik, dhe është i dobishëm kur ZKA kërkon fonde shtesë për punën e tyre.

3.5 Raportimi i rezultateve të përcjelljes

Çfarëdo metode që përdoret, rezultatet nga përcjellja duhet të raportohen në mënyrë të përshtatshme, në mënyrë që t'u ofrohet informatë kthyesë legjislativ. Është praktikë e mirë t'u raportohet palëve përgjegjëse apo legjislativit lidhur me mangësitë dhe përmirësimet e identifikuar gjatë auditimit përcjellës.

Përcjellja mund të raportohet individualisht apo si raport i konsoliduar. Nëse disa përcjellje raportohen së bashku, mund të përfshijnë një analizë të auditimeve të ndryshme, mundësisht duke theksuar tendencat dhe temat e përbashkëta në një numër fushash raportuese. Cilado qoftë forma, raportet përcjellëse duhet të jenë të balancuara dhe gjetjet të paraqiten në mënyrë objektive dhe të drejtë.

4. PËRSHKRIMI I SISTEMIT PËRCJELLËS TË REKOMANDIMIT TË AUDITIMIT

Përgjegjësia për përcjelljen e rekomandimeve të auditimit dhe raportimin mbi rezultatet e zbatimit duhet të jetë e udhëheqësit të ekipit të auditimit apo e një zyrtari tjetër të ZKA të caktuar nga udhëheqësi i departamentit të auditimit dhe në koordinim me Auditorin e Përgjithshëm. Përcjellja e rekomandimeve të auditimit dhe raportimi lidhur me rezultatet e zbatimit të rekomandimeve përcaktohet me Procedurë për sigurimin dhe përcjelljen e rekomandimeve të auditimit të performancës të miratuar me urdhër të Auditorit të Përgjithshëm.

Personi i caktuar për përcjellje të rekomandimeve dhe raportimin e rezultateve të zbatimit, mundë të caktohet gjithashtu për të monitoruar ose për tu koordinuar nga afër me personin i cili monitoron ekzekutimin e rezolutave dhe vendimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe komisioneve të tij sipas materialit të auditimit.

4.1 Databaza për rekomandimet përcjellëse të auditimit

Mënyra më e mirë për të mbajtur dhe menaxhuar me bazën e të dhënave përcjellëse për zbatimin e rekomandimeve është mënyra elektronike. Ruajtja e kopjes rezervë (back up) duhet të bëhet në baza të rregullta dhe të ruhet në një memorie (hard drive) të veçantë apo ndonjë softuerë relevant dhe të mbahet në një vend të mbrojtur nga zjarri, përmbytja ose forca të tjera madhore.

Aktivitetet kryesore që ndërlidhen me bazën e të dhënave për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve janë treguar në hapat e paraqitur në vijim.

Hapi 1: Zhvillimi i bazës së të dhënave për rekomandimet e auditimit të performancës

ZKA duhet të krijojë një bazë të të dhënave që përmban rekomandimet e auditimit për çdo raport të auditimit². Kjo bazë e të dhënave duhet të përditësohet nga drejtori i departamentit përkatës, i cili është përgjegjës për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e statistikave bazuar në përgjigjet e pranuar nga të audituarit. Baza e të dhënave mbahet në fletët e programit excel dhe një çelës përdoret në kolona të ndjeshme i cili çelës do të mbahet vetëm nga menaxherët e kësaj baze të të dhënave për t'u siguruar që nuk do të bëhen ndryshime të paautorizuara në bazën e të dhënave.

Statusi i rekomandimeve të auditimit është si në vijim:

- **I zbatuar** – Rekomandimi është zbatuar me sukses.

² Shtojca 1 e këtij udhëzuesi për përcjellje të AP

- **Zbatimi ka filluar** – Disa masa janë ndërmarrë në drejtim të implementimit të rekomandimit, mirëpo progresi i zbatimit është ende në fazë të hershme.
- **Zbatimi në fazën përfundimtare** – Masat e duhura janë ndërmarrë nga i audituari në drejtim të zbatimit të rekomandimit dhe zbatimi është në fazën përfundimtare për të përfunduar plotësisht.
- **Zbatimi nuk ka filluar** – Deri tani nuk është ndërmarrë asnjë masë nga ana e të audituarit për të zbatuar rekomandimin, mirëpo është prezantuar një plan veprimi.
- **I pa adresuar** – Nuk janë marrë masa dhe nuk është prezantuar asnjë plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve.
- **Nuk aplikohet më** – Për shkak të ndryshimeve përbrenda strukturës të së audituarit ose për ndonjë arsye tjetër, rekomandimi nuk është më relevant për të audituarin.

Përcjellja e implementimit të rekomandimeve të Auditimit të Performancës do të bëhet në baza gjashtë-mujore, ndërsa raporte përmbledhëse të hartohen në baza vjetore. Baza e të dhënave përmban informatat në vijim:

Numri i rekomandimeve tregon numrin e rekomandimeve të subjektit;

Numri i raportit të auditimit tregon numrin e raportit specifik në mënyrë që të mundësohet përcjellja e auditimit përkatës;

Rekomandimet në bazën e të dhënave duhet të shkruhen në formë të përmbledhur, gjithëpërfshirëse dhe të kuptueshme për përdoruesit e bazën e të dhënave, duke treguar qartë se cili është qëllimi i rekomandimit. Kjo kolonë do të ndihmojë menaxhmentin e ZKA të organizojë procesin përcjellës duke filtruar raporte specifike të auditimit për përcjellje dhe gjithashtu të ketë një pasqyrë të qartë të rekomandimeve të zbatuara të auditimit përkatës.

Subjekti përgjegjës tregon subjektin përgjegjës për zbatimin e rekomandimit specifik. Nëse rekomandimi i është drejtuar një grupi të institucioneve (d.m.th. Të gjitha komunave), atëherë procesi përcjellës duhet të kryhet me të gjitha komunat.

Kjo kolonë do të ndihmojë menaxhmentin e ZKA të organizojë procesin përcjellës duke filtruar subjekte apo grupe të subjekteve për proces të dhe gjithashtu të ketë një pasqyrë të qartë të performancës së tyre.

Afati përfundimtar ka dy kolona që ndan afatin përfundimtar origjinal dhe afatin përfundimtar aktual. Afati përfundimtar origjinal tregon datën e përcaktuar në planin e veprimit pas nxjerrjes të raportit të auditimit, ndërsa afati përfundimtar aktual tregon afatet përfundimtare pasuese në rast se subjekti nuk ka zbatuar rekomandimin në afatin origjinal.

Statusi sipas raporti paraprak tregon statusin e rekomandimit specifik nga gjashtë-mujori i mëparshëm i procesit përcjellës.

Vonesat: Vonesat në implementimin e rekomandimeve paraqiten duke specifikuar numrin e muajve (një muaj atëherë kur vonesa është më shumë se një muaj) apo viteve varësisht sa është vonesa.

Statusi sipas raportit aktual tregon statusin e rekomandimit specifik nëse nuk është zbatuar gjatë gjashtë-mujorit të mëparshëm të procesit përcjellës.

Kolona e **përgjigjes së menaxhmentit** përdoret për të treguar përgjigjen e menaxhmentit nëse ka pasur ndonjë arsye për mos zbatimin e rekomandimeve apo veprimeve në procesin e zbatimit të rekomandimit.

Komentet e auditorëve janë të hapura për auditorët përgjegjës në procesin përcjellës, ku tregohet opinioni i auditorëve lidhur me përgjigjen e menaxhmentit dhe gjendjen e zbatimit.

Tabelat në përmbledhjen e statusit të rekomandimeve bazuar në raportet e auditimit janë të lidhura me formula në mënyrë që automatikisht të gjenerojnë statusin e çdo rekomandimi përcjellës, duke llogaritur në mënyrë automatike numrin e statusit të hapur për çdo rekomandim³. Statusi i përgjithshëm 'i hapur' tregon që raporti përkatës i auditimit ka nevojë për proces përcjellës derisa të gjitha rekomandimet të zbatohen apo nuk është i aplikueshëm. Për përdorim të lehtë të data bazës gjatë punës përcjellëse, çdo status i zbatimit të rekomandimit është me ngjyrë specifike që përfaqëson statusin përkatës.

Hapi 2: Lëshimi i Raportit të Auditimit të Performancës

Letra e ZKA e shoqëruar me raport lëshuar subjektit të audituar/ve duhet të kërkojë nga i/të audituari/t të ofrojnë përgjigje ZKA-së brenda 30 ditëve nga lëshimi i raportit lidhur me veprimet që janë ndërmarrë për të adresuar çdo rekomandim të raportit të auditimit. Përgjigja e të audituarit për secilin rekomandim duhet të:

- a) Tregojë nëse pajtohet apo jo me rekomandimin e raportit;
- b) Të jep shpjegim nëse nuk pajtohet me rekomandimin;
- c) Për rekomandimet e pajtuara, të shpjegojë çfarë veprime janë marr apo do të merren për zbatimin e rekomandimit dhe, nëse zbatohet plotësisht, të ofrohet dokumentacion i duhur për të mbështetur zbatimin e rekomandimit;
- d) Për rekomandime që pajtohet por nuk janë zbatuar plotësisht, shpjegoni statusin e zbatimit, çfarë veprimesh shtesë nevojiten për zbatimin e plotë të rekomandimit dhe siguroni një datë të synuar se kur rekomandimi do të zbatohet plotësisht; dhe
- e) Identifikoni një pikë kontakti brenda organizatës, i cili mund të përgjigjet në pyetjet që ZKA mund të ketë në lidhje me statusin e rekomandimeve. Përfshini informacionet e kontaktit: emrin, numrin e telefonit dhe adresën e postës elektronike.

Shënim: Informatat paraprake lidhur me rekomandimet e auditimit duhet të futen në bazën e të dhënave pas lëshimit të raportit. Disa informata, të tilla si statusi dhe data e synuar e zbatimit nuk do të jenë në dispozicion në këtë kohë.

³ Shtojca 2 e këtij udhëzuesi për përcjellje të AP

Hapi 3: Pranimi e Përgjigjes nga i Audituari lidhur me Veprimet e Ndërmarrë për të Adresuar Rekomandimin e Auditimit

- a) Informata e pranuar nga i audituari duhet të rishikohet për të përcaktuar statusin e rekomandimit dhe nëse rekomandimi mund të konsiderohet i zbatuar (apo i mbyllur). Sugjeroni që ekipi i auditimit të performancës përgjegjës për raportin e auditimit në fjalë të bëjë këtë përcaktim.
- b) Bazuar në parashtrimin fillestar të informatës nga ana e të audituarit dhe shqyrtimit të kësaj informate nga ekipi i auditimit, ekipi duhet të përcaktojë statusin e rekomandimeve të auditimit në fjalë dhe të sigurojë këtë informacion mbi statusin për këdo që është përgjegjës për mirëmbajtjen e bazën e të dhënave së rekomandimeve të auditimit.
- c) Nëse përcaktohet që nevojitet informacion shtesë nga i audituari, ekipi i auditimit duhet të kontaktojë personin e caktuar kontaktues të subjektit të audituar dhe të kërkojë informata shtesë, duke shpjeguar përse nevojiten informacione shtesë, dhe dhënien e një datë kur kjo informatë duhet t'i sigurohet ZKA.
- d) Pas pranimit të informatës së kërkuar shtesë, ekipi i auditimit duhet të shqyrtojë atë informatë dhe të bëjë një përcaktim nëse informata është adekuate dhe si është statusi i rekomandimit në fjalë. Nëse informacioni i paraqitur nga i audituari ende nuk konsiderohet adekuat, ekipi i auditimit duhet përsëri të kontaktojë të audituarin dhe të shpjegojë pse informacioni i dhënë nuk është adekuat, dhe çfarë dhe kur informacioni shtesë është i nevojshëm. (Në këtë pikë ndoshta do të ishte përparësi për ekipin e auditimit të takohet personalisht me të audituarin për të zgjidhur secilën çështje).

Hapi 4: Përcjelljet gjashtëmujore për rekomandimet e pa implementuara

- a) Në fund të çdo gjashtë-mujori duhet të bëhet përcjellja e implementimit të rekomandimeve, ndërsa në baza vjetore përpilohet një raport ku do të listohen rekomandimet e auditimit (sipas raportit dhe subjektit përgjegjës) që janë ende të pazgjidhura (të pa zbatuara).
- b) Për ato rekomandime të auditimit që kanë qenë të pazgjidhura më shumë se gjashtë muaj dhe për të cilat ZKA nuk ka informacion për statusin e tyre të zbatimit gjatë gjashtë muajve të fundit. Departamenti i auditimit të performancës apo departamenti i metodologjisë, duhet të kontaktojë të audituarin (me shkrim, postë elektronike ose përmes telefonit) dhe të kërkojë nga i audituari që të sigurojë informata të përditësuara lidhur me veprimet që janë ndërmarrë për zbatimin e rekomandimit dhe datën e synuar për përfundim.
- c) Informata e pranuar gjatë procesit përcjellës së gjashtë mujorit duhet të përdoret për të përditësuar statusin e rekomandimeve të përfshira në bazën e të dhënave.

Hapi 5: Nxjerrja e raporteve vjetore për statusin e rekomandimeve të auditimit të performancës

- a) Departamenti i Auditimit të Performancës dhe/ose Departamenti i Metodologjisë në baza vjetore duhet të nxjerr raporte përmbledhëse lidhur me statusin e rekomandimeve të auditimit të performancës (këto raporte janë përshkruar në Hapin_1 më lartë).

Shtojca 1, Tabela 1: Databaza e Rekomandimeve Përcjellëse të Auditimit

Nr.	Titulli i Raportit të Auditimit	Rekomandimi	Subjekti përgjegjës	Data e raportit	deri më 30.01.20XX		deri më 30.06.20XX			
					Afati përfundimtar (Plani i Veprimit)	Statusi i Rekomandimit	Vonesa	Përgjigja e Menaxhmentit (Dëshmitë aty ku duhet)	Komentet e Auditorëve	Statusi i Rekomandimit
1	12345678	A	MMPH	01.01.20XX	01.01.20XX	Zbatimi ka filluar	12 muaj	Koment	Koment	I zbatuar
2	12345678	B	MMPH	01.01.20XX	01.01.20XX	I pa adresuar	Më shumë se 2 vite	Koment	Koment	I pa adresuar
3	91011121	C	TGjK	01.01.20XX	01.01.20XX	Zbatimi nuk ka filluar	5 muaj	Koment	Koment	I zbatuar
4	91011121	D	TGjK	01.01.20XX	01.01.20XX	Zbatimi ka filluar	I implementuar në kohë	Koment	Koment	I zbatuar
5	14512389	E	KOb	01.01.20XX	01.01.20XX	Zbatimi në fazën përfundimtare	I implementuar në kohë	Koment	Koment	I zbatuar
6	14512389	F	Kgja	01.01.20XX	01.01.20XX	Zbatimi ka filluar	2 muaj	Koment	Koment	Zbatimi në fazën përfundimtare
7	45983587	G	KPr	01.01.20XX	01.01.20XX	I pa adresuar	Më shumë se 3 vite	Koment	Koment	Nuk aplikohet më
8	155468864	H	KOb	01.01.20XX	01.01.20XX	Zbatimi nuk ka filluar	3 muaj	Koment	Koment	I zbatuar
9	155468864	I	KOb	01.01.20XX	01.01.20XX	I pa adresuar	Më shumë se 2 vite	Koment	Koment	Zbatimi nuk ka filluar
10	155468864	J	KOb	01.01.20XX	01.01.20XX	Zbatimi në fazën përfundimtare	I implementuar në kohë	Koment	Koment	I zbatuar

Burimi: Data baza përcjellëse, Tabela përcjellëse, Lista e Detajuar e Rekomandimeve Përcjellëse

Shtojca 3. Diagrami i rrjedhës së procesit përcjellës të auditimit së ZKA